

Puna e padeklaruar në Kosovë

Ardiana Gashi

Përmbajtja

1. Ekonomia joformale në Kosovë;
2. Shkalla e punës së padeklaruar në Kosovë;
3. Pengesat për formalizimin e punëtorëve: vështrim teorik dhe evidencë për Kosovën;
4. Korniza institucionale për luftimin e punës së padeklaruar në Kosovë;
5. Disa praktika të mira në Kosovë; dhe
6. Rekomandime të përgjithshme.

1. Ekonomia joformale në Kosovë

- Ekonomia joformale llogaritet të jetë 32% e Brutp Produktit vendor (Studimi i mbështetur nga Komisioni Evropian në vitin 2017)
- Sipas Studimit të Bankës Botërore me Ndërmarrjet, 7 në 10 ndërmarrje të formalizuara theksojnë se janë në konkurrencë me ndërmarrje joformale
- Afër 60% theksojnë se konkurrenca me ndërmarrje joformale është pengesë serioze për zhvillimin e bizneseve e tyre.

2. Shkalla e punës së padeklaruar në Kosovë

Anketa e Fuqisë Punëtore ofron të dhëna për 2 tregues:

1. Punësimi i paqëndrueshëm/cenueshëm

- Një në 4 punëtorë janë në punësim të paqëndrueshëm/cenueshëm=punëtorë të papaguar familjar dhe të vetëpunësuar pa punëtorë
- Karakteristikë e punësimit të paqëndrueshëm në Kosovë është se 1/3 janë punëtorë të papaguar familjar, pjesëmarrje dukshëm më e lartë se në 28 vendet e BE-së (10.2%)-kjo mund të nënkuptoj se punësimi i pacenueshëm në Kosovë nuk është zgjidhje vullnetare por është një strategji për mbijetesë

2. Të punësuarit pa kontratë pune

Në vitin 2017, 21.5% e të punësuarve nuk kishin kontratë pune

- Të rinjtë, burrat dhe punëtorët me nivel të ulët të shkollimit karakterizohen me shkallë të më lartë të punësimit të padeklaruar

2. Shkalla e punës së padeklaruar në Kosovë

	Burimi i të dhënave	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Punësimi i paqëndrueshëm/cenueshëm	ASK	16.8	23.6	24.9	22.8	22.9	23.1
Të punësuar pa kontrata	ASK	16.6	18.0	15.5	15.5	26.3	21.5
Punësimi i paqëndrueshëm/cenueshëm	MCC						40.8
Të punësuar pa kontrata	MCC						34.6

2. Shkalla e punës së padeklaruar në Kosovë

‘Pagesë në zarf-envelope ëages’

Bazuar në një raport të vitit 2016, 22.6% e punëtorëve me kontrata, pranojnë paga më të larta sesa vlera e shënuar në kontratë.

3. Pengesat për formalizimin e punëtorëve: vështrim teorik

Bazuar në numër të konsiderueshëm të studimeve identifikohen një varg faktorësh që lidhen me punën e padeklaruar, e më të rëndësishmet janë:

- Bruto Produkti Vendor për kokë banori i ulët
- Korrupsioni i lartë dhe cilësia e dobët qeverisëse
- Shpenzimet e ulëta për mbështetjen e punësimit, posaçërisht për të ndihmuar grupet e marginalizuara
- Shpenzimet e ulëta sociale, dhe
- Sistemet e transfereve sociale, me ndikim të kufizuar në zvogëlimin e pabarazive dhe për të mbështetur grupet në nevojë.

3. Pengesat për formalizimin e punëtorëve: evidencë për Kosovën

- BPV për kokë banori në vitin 2017 është më e ulta në rajon (3,957 \$)
- Vetëm 29.8% janë të punësuar
- Bazuar në Transparency International, Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit, në vitin 2018 Kosova në vendin e 93-të, me indeks prej 37 pikë (0 shumë i korruptuar, 100 i pastër)
- Barometri i Ballkanit në vitin 2017 ka gjetur:
 - 72% e individëve pajtohen se gjyqësori është i korruptuar;
 - 68% besojnë se shëndetësia, parlamenti dhe zyrtarët/shërhyesit publik janë të korruptuar, dhe
 - 62% vlerësojnë se sistemi i arsimit është i korruptuar

3. Pengesat për formalizimin e punëtorëve: evidencë për Kosovën

- Sipas një studimi të vitit 2017, nga INFORM nga 1 aspak besim deri në 10 besim i plotë, në Kosovë mesatarja ishte 4 që do të thotë se ekziston besim i ulët në institucione por edhe në mes të njerëzve
- Në vitin 2017, vetëm 1.8 milionë Euro ose 0.02% e BPV-së është shpenzuar për Masa Aktive të Punësimit (MATP-të), për të mbështetur 101,773 të papunë të regjistruar në Agjencinë e Punësimit.
- Vetëm 10% e të papunëve kanë përfituar nga MATP-të dhe atë kryesisht në formë të trajnimeve në Qendrat e Aftësisimit Profesional

3. Pengesat për formalizimin e punëtorëve: evidencë për Kosovën

- Në vitin 2015, 17.6% e Kosovarëve kanë jetuar në varfëri dhe 5.2% në varfëri ekstreme
- Të dhënat nga Anketa Life in Transition në vitin 2016 se 40% e Kosovarëve nuk do të ishin në gjendje të mbulonin shpenzime të paparashikueshme.
- Në vitin 2017, 22% e buxhetit është shpenzuar është për transfere dhe skema sociale (pensione, ndihmë sociale, etj.)
- Në vitin 2011, më pak se 1/3 e familjeve kanë pranuar ndihmë sociale
- FMN (2018) ka raportuar se Kosova është orientuar nga beneficione për ndihmë të varfërve drejt përfitimeve që lidhen me luftën: në vitin 2010, ndihma sociale përbënte v17% të mbështetjes sociale ndërsa në vitin 2017, përbënte vetëm 8% të mbështetjes sociale

3. Pengesat për formalizimin e punëtorëve: evidencë për Kosovën

- Studimet ekzistuese theksojnë se normat e larta tatimore janë arsyet për punën e padeklaruar. Megjithatë, evidenca tregon për efekt të vogël ose aspak ndërlidhje në mes të madhësisë së normave tatimore dhe punës së padeklaruar
- Në Kosovë, normat tatimore janë ndër më të ultat në rajon, ku të hyrat nga taksat janë 22.6% e BPV (Banka Botërore, 2017), ndërsa shkalla e informalitetit është e lartë

3. Pengesat për formalizimin e punëtorëve: evidencë për Kosovën

- Studimi i vitit 2013 realizuar nga Riinvest ka gjetur se ekziston një nivel i ulët i frikës për tu 'kapur nga shteti' nëse fsheh tatimin-vetëm 37% e ndërmarrjeve kanë theksuar se ekziston probabilitet i lartë ose shumë i lartë për tu identifikuar për fshehje të tatimit
- 63% kanë theksuar se lehtësisht mund të gjejnë forma për mashtrim-mos pagesë të tatimit
- 42% e ndërmarrjeve kanë theksuar se i konsiderojnë denimet e larta ose shumë të larta

4. Korniza institucionale për luftimin e punës së padeklaruar në Kosovë

Institucionet e mandatuara për luftimin e informalitetit janë:

- Ministria e Financave, Administrata Tatimore e Kosovës; dhe
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Inspektorati i Punës

Partnerët social

1. Përfaqësuesit e punëtorëve,
2. Përfaqësuesit e punëdhënësve; dhe
3. Shoqëria civile

4. Korniza institucionale për luftimin e punës së padeklaruar në Kosovë

Roli i Ministrive të tjera:

- **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**, e cila ka interes për të parandaluar dhe zvogëluar punën e padeklaruar në sketorit e bujqëisë dhe pylltarisë;
- **Ministria e Zhvillimit Ekonomik**, e cila ka interes për të parandaluar dhe zvogëluar punën e padeklaruar në sektorin e energjisë, ujit, minierave, telekomunikacionit dhe sektorit të teknologjisë së informacionit;
- **Ministria e Tregtisë dhe Industrisë**, e cila ka interes për të parandaluar dhe zvogëluar punën e padeklaruar në sektorinë e tregtisë, turizmit dhe industrisë.
- **Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**, e cila ka interes për të parandaluar dhe zvogëluar punën e padeklaruar tek të rinjtë, në sektorin e kulturës dhe sportit;
- **Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë**, e cila ka interes për të parandaluar punën e padeklaruar në ndërmarrjet e reja dhe në TIK; dhe
- **Ministria e Zhvillimit Rajonal**, e cila ka interes për të parandaluar dhe zvogëluar punën e padeklaruar në të gjithë sektorët!!!

4. Korniza institucionale për luftimin e punës së padeklaruar në Kosovë

Dokumentet Strategjike:

Strategjia Nacionale 2016-2020 synon në zvogëlimin e punësimit joformal

Kosova ka zhvilluar 3 dokumente strategjike për luftimin e informalitetit: 2008 - 2009; 2010 - 2012; dhe 2014-2018

Aktualisht është duke u punuar Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023

Strategjia Sektoriale e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018-2022: ka objektivë specifike për luftimin e punësimit joformal

4. Korniza institucionale për luftimin e punës së padeklaruar në Kosovë: sfidat kryesore

1. Sfidat për arritjen e rezultateve më të mira nga qasja aktuale për luftimin e punës së padeklaruar

- Kordinimi i kufizuar në mes të institucioneve;
- Numri i kufizuar i inspektorëve të punës, nevoja për ngritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e kushteve të punës;
- Nevoja për përmirësimin e targetimit të punëdhënësve; dhe
- Informim i kufizuar i publikut për pasojat në afat të shkurtër dhe të gjatë nga punësimi joformal.

2. Mungesa e stimujve për formalizim

4. Korniza institucionale për luftimin e punës së padeklaruar në Kosovë: Disa praktika të mira në Kosovë

- ATK ka metodologji të avancuar për vlerësimin e rrezikut dhe targetimin e bizneseve për inspektim;
- ATK ofron shërbime më të shpejta për taksapaguesit e rregullt dhe mëdhenjë;
- ATK dhe Odat Ekonomike çdo vit zgjedhin taksapaguesin më të madhë në vend;
- Inspektorati i Punës organizon fushata për vetëdijësimin lidhur me punësimin joformal;
- ATK ka zbatuar programin për reimbursemin e kuponëve fiskal, i cili program ka sjellë rezultate konkrete;
- ATK në baza të rregullta organizon aktivitete informuese dhe vetëdijësuese për kontributin e tatimeve për zhvillimin socio-ekonomik në vend;
- Inspektorati dhe ATK operojnë linjë falas telefonike për raportimin e rasteve.

5. Rekomandime të përgjithshme: me efekte në afat të gjatë

- Rritjen e Bruto Produktit për kokë banori;
- Përmirësimin e qeverisjes dhe zvogëlimin/eliminimin e korrupsionit;
- Rritjen e mbështetjes për punësim; posaçërisht për grupet e marginalizuara;
- Rritjen e efikasitetit të sistemit të transefereve sociale.

Falemnderit!

Rekomandimet specifike

1. Për rritjen e efekteve nga qasja e aplikuar aktualisht; dhe
2. Propozime për aplikimin e masave të reja

Rekomandimet specifike

1. Iniciativat strategjike

1. Qasje holistike për punën e padeklaruar: themelimi i një grupi kordinues për veprim të përbashkët, duke përfshirë orientimet strategjike, shkëmbimin e të dhënave dhe analizat për punën e padeklaruar;
2. Të rishikohen objektivat strategjike të institucioneve të mandatuara: përfshirja e objektivit për transformimin e punës së padeklaruar në punë të deklaruar; dhe
3. Përmirësimi në matjen e performancës.

Rekomandimet specifike

2. Masat për rritjen e rrezikut dhe kostos nga punësimi i padeklaruar për punëdhënësit

- Zgjerimi i bazës për gjob: me rëndësi është trajtimi i barabartë për shkelësit e ligjit;
- Krijimi i regjistrit për punëdhënësit e gjobitur për punësimin e padeklaruar;
- Përmirësimi i efektivitetit të sistemeve elektronike të të dhënave, shkëmbimit të të dhënave dhe analizës së të dhënave;
- Aplikimi i letrave paralajmëruese, bazuar në analizën e të dhënave-propozohet të bëhet pilotimi i kësaj mase;
- Përmirësimi i targetimit dhe planifikimit të inspektimeve;
- Zbatimi i përgjegjësive në zinxhirin e vlerës në kontratat publike: përfshirja e një neni të veçantë në kontrata publike, me ç'rast pala kontraktuese do të marrë masa për të siguruar se nën-kontraktorët deklarojnë të gjithë puëntorërt: dhënave-propozohet të bëhet pilotimi i kësaj mase.

Rekomandimet specifike

3. Stimujt për formalizimin: masat në anën e ofertës-për bizneset dhe punëtorët e padeklaruar

- ‘Lista e bardhë’ për punëdhënësit që deklarojnë të gjithë punëtorët (!) për kontrata publike;
- Shërbime për të mbështetur formalizimin e punëtorëve: ofrimi i mbështetjes për të vetëpunësuarit dhe ndërmarrjet mikro për formalizimin e punëtorëve. Mbështetje shtesë në formë të trajnimeve, pjesëmarrjes në panaire dhe ndërkombëtarizim.

Rekomandimet specifike

4. Stimujt për formalizimin: masat në anën e kërkesës-të orientuara drejt konsumatorëve

- Nxitja e përdorimit të pagesave përmes bankës;
- Aplikimi i lirimeve tatimore për ekonomitë familjare kur angazhojnë punëtorë për ofrimin e shërbimeve: rekomandohet pilotimi i kësaj mase;
- Voucher-subvencion nga shteti për ekonomitë familjare për të paguar shërbimet sic janë: pastrimi, kujdesi për fëmijët; rregullimet në shtëpi, etj.- rekomandohet pilotimi i kësaj mase.

Rekomandimet specifike

5. Ndryshimin e vlerave, normave dhe besimit të qytetarëve

- Organizimi i fushatave informuese dhe vetëdijësuese lidhur me:
 - Përfitimet nga puna e padeklaruar; dhe
 - Humbjet/kostot dhe rreziqet nga puna e padeklaruar
- Edukimi i qytetarëve për sistemin tatimor dhe moralin tatimor: informimi për rolin e tatimeve në jetën e qytetarëve.

Rekomandimet specifike

6. Reformimi i institucioneve

- Trajnimi i inspektorëve, drejt një qasjeje miqësore;
- Modernizimi i proceseve menaxhuese të Inspektoratit të Punës: identifikimi dhe zbatimi i praktikave të mira në vendet e Bashkimit Evropian.

Rekomandimet specifike

7. Përmirësimi i përfshirjes së partnerëve social

- Zbatimi vullnetar i përgjegjësisë së punëdhënësve në zinxhirin e vlerës: kjo mund të pilotohej me 10-15 punëdhënës të mëdhenjë;
- Ofrimi i mbështetjes dhe këshillimit nga vet ndërmarrjet: kryesisht punëdhënësit më me përvojë të ofrojnë këshilla dhe mbështetje për ndërmarrjet e reja.

Falemnderit!